



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.01.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar Komisioni

Rendi i ditës:

1. Miratimi i programit trijavor të punës në komision.
2. Projektligji “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, ratifikuar me ligjin nr. 40/2012”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Arben Pëllumbi, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Gjetan Gjetani, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Dorina Çinari - Zëvendësministre e Energjetikës dhe Infrastrukturës

Agim Bregasi - Drejtor në Ministrinë e Energjetikës dhe Infrastrukturës

Fatmir Elezi - inxhinier KESH

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje!

Meqenëse ora ka shkuar dhe kuorumi është prezent, fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese.

Dua të shpreh falënderimin tim për të gjithë deputetët që më besuan drejtimin e këtij komisioni! Në fakt, është një komision që unë e kam parë në pozicion tjetër, por realisht është nga komisionet që ka punuar shumë mirë dhe që është dalluar edhe për të ndërtuar një axhendë, që shpeshherë e ka kaluar edhe retorikën politike të fokusuar te puna me një dimension shumë të fortë në marrëdhënie me institucionet, por edhe me grupet e interesit, përmes dëgjësive dhe kontakteve shumë të mira të vendosura deri tani.

Jam i vetëdijshëm që po e fillojmë punën së bashku me një standard me të vërtetë shumë të mirë dhe zotohem që do të punoj përkrah jush dhe gjithë anëtarëve të komisionit, pavarësisht përkatësisë politike, për të bërë një punë të mirë në vazhdim në procesin e ligjbërjes, kaq shumë të rëndësishëm për vendin.

Besoj se do t'ia dalim që të jemi gjithnjë e më të plotë në pjesëmarrje edhe me prezencën e opozitës. Falënderoj ata që janë prezentë, por besoj se do të na bashkohen edhe të tjerë!

Për të qenë korrekt me orarin, meqenëse kuorumi është plotësuar, po fillojmë pa humbur kohë me rendin e ditës. Sot në rendin e ditës kemi vetëm një pikë për diskutim dhe unë do të propozoj të bëjmë edhe miratimin e kalendarit për javët në vazhdim të komisionit.

Rendi i ditës për sot është: projektligji “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, ratifikuar me ligjin nr. 40/2012”. Relator i këtij projektligji është zoti Besnik Baraj, i cili do të thotë dy fjalë dhe pastaj përfaqësuesit e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës do të bëjnë prezantimin e projektligjit.

Faleminderit!

Besnik Baraj – Faleminderit!

Urime dhe suksese për këtë vit, meqenëse është mbledhja e parë që drejtoni në këtë komision!

Është e disata herë që mblidhemi për këtë problematikë, sigurinë e digave dhe optimizimin e tyre, me qëllim që të ketë eficiencë maksimale shfrytëzimi i rezervuarëve në përgjithësi. Bëhet fjalë për një rishpërndarje fondesh, meqenëse mbas kontrollit në terren është parë që kanë dalë probleme, të cilat kërkojnë ndërhyrje dhe rivlerësim.

Dy janë arsytet pse bëhet kjo: siguria e digave duhet të ishte vlerësuar kohë më parë, por sidoqoftë asnjëherë nuk është vonë sa kohë nuk kemi pasur ndonjë problematikë të rëndë, dhe në anën tjetër, rritja e eficiencës së shfrytëzimit të rezervuarëve duke parë portat e ndryshme që janë në këto vepra.

Personalisht, do të thosha se specialistët e ministrisë mund të na japin disa sqarime më gjerë, qoftë edhe për kuriozitet, të cilat nuk janë shprehur në relacion.

Ju ftoj ta votojmë këtë projektligj në finale.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Baraj!

Fjala për përfaqësuesit e ministrisë, zëvendësministrja.

Dorina Çinari – Mirëmëngjesi!

Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

Sikurse tha zoti Baraj, sot para jush kemi sjellë projektligjin për miratimin e një rialokimi fondesh nga financimi i IBRD-së për projektin e sigurisë së digave. Gjithashtu, ju thatë që ne kemi ardhur disa herë para jush për miratime të ndryshme. Projekti i digave është një projekt shumë i madh, i cili ka filluar në vitin 2008. Ka 4 donatorë të mëdhenj, Banka Botërore, IBRD-ja, SECO dhe KfW-ja.

Sot po flasim për financimin nga Banka për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), në masën 15.5 milionë euro. Faktikisht, kërkojmë një rialokim fondesh, nga zëri “asistencë teknike”, në zërin “investime”. Rialokimi i fondeve vjen për pasojë se kanë përfunduar punimet që ishin parashikuar në studimin për asistencën teknike. Ka një kursim fondesh dhe është rënë dakord me donatorin që ky financim i mbetur të përdoret për punime civile dhe infrastrukturë.

Sikurse tha edhe zoti Baraj, projekti i sigurisë së digave ka këta komponentë të rëndësishëm: siguria fizike e digës; përmirësimi i turbinave, rikonstruksioni dhe zëvendësimi i tyre; portat e heceve dhe implementimi i sistemeve të reja të monitorimit, që janë sisteme të monitorimit të portave, të kaskadës etj., pra, ka shumë elemente brenda. Në këtë rast ne kemi

vetëm rialokim të financimit në masën 461 mijë e 250 euro që janë të paalokuara, të ruajtura, për t'i kaluar në zërin "investime". Gjithashtu, kërkojmë edhe shtyrje të afatit të disbursimit të financimit nga viti 2019 deri në fund të vitit 2020, meqenëse do të flasim për punimet civile.

Ky është pak a shumë përshkrimi.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ka pyetje? Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Më lejoni të bëj edhe unë dy shpjegime: për mendimin tim, është investimi i fundit që po bëjmë për Hidrocentralin e Komanit në kuadër të të gjitha ndërhyrjeve që janë bërë qoftë në rritjen e sigurisë së digës, qoftë në rritjen e sektorit të monitorimit, ashtu edhe të kanaleve të shkarkimit, apo edhe të agregateve.

Problemi që lind është pikërisht fakti që pasi janë hapur tri agregatat e Komanit, janë vënë re defektet që ato kanë dhe nevoja për ndërhyrje brenda tyre është më e madhe sesa ajo që kemi parashikuar në fondin që kaluam vitin e shkuar. Kështu që është parë e arsyeshme, që një pjesë e këtij investimi, e cila ndodhet në një llogari të lirë, të mund të përdoret për blerje materialesh pikërisht për këto defekte agregatesh që janë vënë re në momentin që janë hapur. Pra, nuk direshin që përpara deri në çfarë shkalle ishin këto dëmtime dhe në momentin që janë hapur, janë vënë re se çfarë defektesh kanë dhe kërkojnë nevojën e një ndërhyrjeje shtesë, që është gjendur pikërisht ky fond prej 461 mijë e 250 eurosh për të bërë blerje materialesh dhe pajisjesh. Me këtë besoj se e mbylлим të gjithë pjesën e investimit për Hidrocentralin e Komanit dhe kalojmë në një riparim total të plotë të tij. Ndërkohë, besoj se vazhdojnë projekte të tjera për hidrocentralet e tjera të kaskadës.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Baraj ka një pyetje.

Besnik Baraj – Në çfarë intervali kohe a periodiciteti bëhen përgjithësisht investigime të tilla dhe ndërhyrje në praktikën e hidrocentraleve?

Agim Bregasi - Faleminderit për pyetjen!

Me këtë rast po bëjmë një tablo më të gjerë. Sikurse tha edhe zëvendësministrja, këtu kemi një investim shumë të madh për rritjen e sigurisë së digave mbështetur në një studim të bërë në vitin 2008, por në kohën kur është bërë studimi dhe është përcaktuar financimi, që duhet për gjithë hidrocentralet e kaskadës së Drinit qoftë në diga, agregate apo në tunele, porta

shkarkimi e të tjera, ka qenë i përcaktuar dhe pastaj donatorët, sipas mundësive dhe në bashkëpunim me qeverinë shqiptare, kanë përcaktuar se çfarë do të japë secili prej tyre.

Për rastin konkret, sikurse e tha edhe zoti deputet, ka punime të maskuara që nuk dihen në momentin kur është bërë planifikimi, por në bazë të një eksperience të asaj kohe të viteve '85 - '95, që janë hapur agregatet, deri në atë moment kur është caktuar ky fond, është bërë me përafërsi të mjaftueshme, shumë afër të vërtetës. Natyrisht, kur hapet turbina dhe gjeneratori, ka punime të maskuara që nuk duken atë moment nga investiguesit, kështu që lind nevoja për ndërhyrje dhe për financime shtesë.

Ky është një rast unik, të themi, se është hera e parë që ndërhyhet në agregatet e Komanit, pasi ka mbaruar 1, 2, dhe 3-shi, është parë e nevojshme që për agregatin e katërt të vihet në dispozicion edhe ky financim i pakonsumuar deri tani, por e rëndësishme është që është brenda limitit 15.5 milionë euro që është miratuar në vitin 2012.

Për të thënë sa herë hapen, agregatet bëjnë remont kapital një herë në vit.

Remont kapital konsiderohet një ndërhyrje e thellë në pajisjet qoftë mekanike, qoftë elektrike dhe pajisje ndihmëse, pompa e kompresorë e çfarë ka gjithë hidrocentrali apo gjithë agregati dhe, pas një ndërhyrje të tillë të thellë, siç po bëhet tani në Hidrocentralin e Komanit, ndërhyrjet vjetore do të jenë më tepër rutinë mirëmbajtjeje. Me termin kapital, konsiderohet një ndërhyrje e thellë me ndalje të aggregateve, (zakonisht, venë një muaj çdo agregat). Ka një remont të thellë. Ka një fenomen të tillë edhe për hidrocentralet tona, një kavitacion që vjen nga papastërtitë, nga llumrat, zhavorret e gurët e vegjël që rrahin lopatat e turbinës dhe krijojnë kavitacion. Kavitacioni është shumë i dëmshëm, sepse shkatërron turbinën, dhe natyrisht të gjithë centralin.

Duke qenë se është hera e parë që këtij hidrocentrali...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërtim i këtij karakteri. Vit për vit janë bërë, pa diskutim, por deri në atë masë që mund të bëhet me një hapje, saç parashikohet nga remonti kapital. E këtij karakteri është një ndërhyrje shumë e thellë që kërkon edhe specializim edhe ndërhyrje të thella në turbina dhe gjeneratorë, por edhe në elementet e tjera.

Në përgjigje të pyetjes suaj, remonti kapital i aggregateve bëhet një herë në vit me ndalim të plotë të turbinave dhe gjeneratorëve. Ka pastaj elemente, që po t'i hyjmë një nga një, janë: mbushja e fletëve, rasketim të kushinetave, mbushje të kushinetave me babitë e të tjera. Në

rastin konkret, Fierza ka dy agregate të rehabilituara në këtë thellësi, ka ende edhe dy të tjerë për të bërë, ndërsa Komani me këtë ndërhyrje që po miratojmë sot, financimin, mbaron në aspektin e ndërhyrjes kaq të thellë në të gjithë centralin.

Besnik Baraj – Informacioni që kam pasur, jo tani, por edhe në takimet e tjera që kemi bërë, pra bëhet fjalë se nga portat kemi një humbje në rendiment me rreth 10%. A mendoni se me këtë ndërhyrje do të rritet rendimenti i shfrytëzimit të kapaciteteve hidrike me 10% në këtë hidrocentral?

Në Shqipëri ka disa qindra diga të përmasave të ndryshme. Jo rrallë herë kemi dëgjuar që në vende të ndryshme ka pasur aksidente, madje disa prej tyre dramatike. A mendoni se mund të ketë prioritet ndërhyrja në diga të tjera me qëllim që të evitohen raste të kësaj natyre?

Agim Bregasi – Atëherë, po i ndaj gjërat dhe përgjegjësitë. Në Shqipëri janë gjithsej rreth 640 diga të karakterit të madh dhe të vogël, duke futur këtu digat e bujqësisë, që janë përdorur për ujitje dhe digat e hidrocentraleve, që natyrisht shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike. Ish-Ministria e Energjisë apo sektori ynë merret me monitorimin e tri digave ose hidrocentraleve, të Vaut të Dejës, të Komanit, të Fierzës dhe për këtë ka edhe një rregullore shfrytëzimi e miratuar që në vitin 1988, së cilës i qëndrohet me shumë korrektesë dhe deri tani nuk kemi pasur shqetësime në monitorimin e këtyre digave.

Sa u takon digave të tjera përgjegjës për to është Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha, por tani ka edhe një problem tjetër se ish-digat e bujqësisë kanë kaluar në administrimin e pushtetit vendor, i cili realisht e ka vështirësuar punën, sepse pushteti vendor nuk ka kapacitetet e Ministrisë së Bujqësisë qoftë nga pikëpamja teknike dhe e njohurive, qoftë edhe nga pikëpamja financiare për të ndërhyrë.

Në dijeninë time, për këto diga Banka Botërore para disa vitesh ka bërë një studim dhe është ndërhyrë në 12 prej tyre. Tashmë, Komiteti Kombëtar i Digave ka një inventar, por edhe me porosi të ministres së re do të bëhet një verifikim i situatës të të gjitha digave sa u takon problematikave dhe më pas do të gjenden financime, sepse edhe praktika e digave ka ndryshuar, pasi poshtë digave, sidomos atyre të bujqësisë, ka ndërtime pa leje, me leje, lloj-lloj ngatërresash, të cilat e komplikojnë pak situatën. Pra, studimi që do të bëhet nga Komiteti Kombëtar i Digave do të përcaktojë se në cilat diga duhet ndërhyrë, nëse ia vlen të ndërhyhet apo jo, cilat nuk kanë më funksion, sepse nuk kanë më se çfarë të ujisin poshtë, pasi tokat bujqësore janë zënë dhe

mënyra se si do të dalin nga skema, sepse përsëri paraqesin rrezikshmëri për arsye të llumrave apo ujërave që mund të kenë. Kjo është në përgjithësi për digat e bujqësisë.

Sa u takon digave tona, ndërhyrja nëpërmjet një fondi, të cilin ne e miratim këtu te ju në shtator, është edhe ajo e ndërhyrjes në portat e Fierzës dhe të Komanit, që natyrisht rrisin më shumë sigurinë e digave, që të mos ndodhemi para të papriturave. Kurse rendimenti rritet me shkallë, nuk mund ta llogarisim dot tamam, sepse shpesh rriten... Pra, duke pasur frikën e ndonjë aksidenti të mundshëm nga shfrytëzimi i hidrocentraleve, më mirë rrezikon ta mbash në kuota më të ulëta për të mos pasur probleme dhe kjo çon natyrisht në uljen e eficiencës. Pra, duke bërë këto remonte, si dhe ndërhyrjet e portave natyrisht që siguria e digave rritet dhe po ashtu edhe efienca e përdorimit të hidrocentraleve.

Besnik Baraj – Në fakt, unë kisha parasysh portat, të cilat nuk mbyllen plotësisht dhe ka rrjedhje dhe ndoshta nuk është aq e vështirë për të matur debitin e ujërave që dalin për të përcaktuar më pas se sa janë humbjet në rendimet.

Agim Bregasi – Më shumë shqetësuese nga pikëpamja e humbjeve janë portat segment, tri portat në digën e Vaut të Dejës, kurse nga pikëpamja e sigurisë natyrisht më shumë kujdes duhet treguar edhe te digat e Komanit dhe të Fierzës. Sigurisht duhet të ketë edhe matje, por ne nuk ishim të përgatitur dhe nuk i kemi për momentin.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit për sqarimin!

A ka pyetje?

Po, zoti Panariti.

Edmond Panariti – Meqenëse këtë projektligj e kemi kaluar edhe në Komision e Jashtëm, pra bëhet fjalë për një ratifikim marrëveshjeje, kam sugjeruar edhe atëherë, por po e sugjeroj edhe tani në trajtën e pyetjes: pse në titullin bazë, meqenëse titulli nuk mund të ratifikohet, është modifikuar përmbajtja? Pra, duhet thënë (i ndryshuar). Për sa kohë që ne kemi ndryshim të zërave nga pikëpamja e financimit, një zë është i mbiplanifikuar si financim dhe nga ky kërkohet të hiqet dhe të kalohet te zëri i investimeve konkrete meriton që titulli të ndryshohet. Në kllapa të thuhet, sepse ky është titulli bazë, (i ndryshuar), pasi nga ne kërkohet miratimi për ndryshim të financimit, që të jemi korrekt nga pikëpamja e emërtesës ligjore.

(Diskutime pa mikrofon)

Ky nuk është financim shtesë, por bëhet fjalë për një ndryshim brenda financimit bazë. Ky është titulli bazë dhe në kllapa duhet vendosur fjala (i ndryshuar), sepse këtu kërkohet

miratimi për transferimin e një zëri që rezulton i mbifinancuar. Pra, këtu dalim më pas edhe të çështja tjetër, pse në studimin e fizibilitetit del që një zë jooperativ, por me sa duket studimor, del i mbifinancuar, ndërsa zëri ndërhyrës del i nënfinancuar dhe tashmë kërkohet që ajo shtesë të shkojë atje ku duhet. Çështja më pas do të kërkojë më shumë diskutim, sepse ky është një problem që ne e hasim rëndom në cedimet e rënda, në studimet e fizibilitetit dhe në ndërhyrjet investuese qofshin këto për diga apo për rrugë. Preventivi del ndryshe, më pas i rikthehemi dhe thonë: jo nuk e kemi planifikuar mirë, kërkohet financim shtesë, ndryshim e kështu me radhë.

Për mendimin tim këto gjëra duhet të disiplinohen, pse jo, kush e ka marrë përsipër këtë studim fizibiliteti, për sa kohë që kemi diskordanca të tilla, duhet të mbajë edhe përgjegjësi. Ne nuk mund të vazhdojmë tani të diskutojmë jo po dolën gjëra të paparashikuara, nuk e patëm menduar mirë e të tjera, sepse sa herë që kalojmë të tilla situata duhet të vijmë këtu dhe të korrektojmë ne si deputetë, si vendimmarrës pikërisht cedime që janë të karakterit studimor dhe të fizibilitetit, sepse këtu natyrisht fshihen edhe tendenca abuziviste. Ky është një debat i ngritur, besoj se ju e dini, duke filluar që nga Astiri, ndërhyrjet në rrugë, ku ndryshe del preventivi fillestar dhe më pas kur u rikthehemi dhe plasim gjërat, del që jemi shumë më poshtë asaj vlere nominale të përcaktuar.

Unë mendoj se në parim duhet të jemi shumë të kujdesshëm, prandaj fillimisht kërkoj të modifikohet titulli dhe sigurisht më pas kërkoj edhe një shpjegim se përse në studimin e fizibilitetit nuk është parashikuar saktë sa do të jetë shuma e kolona studimore, e cila rezulton e mbifinancuar dhe pse ne cedojmë të ndërhyrja operationale. Më pas qëndron edhe çështja që u tha pak më parë, pasi mua më duket që kjo është maja e ajsbergut nga pikëpamja e nevojave tona e ndërhyrjes nëpër diga.

Zoti kryetar, ne të dy kemi qenë ish-ministra të Bujqësisë dhe e dimë se ka pasur një problem të jashtëzakonshëm, i cili është ende aty, mungesa e financave në investimeve të digat e rezervuarëve. Zotëria na tha se aty qëndron rreziku për efekt cunami, ndërsa unë po ju them diçka. Kur kam qenë ministër, jam përballuar, por kanë qenë vetëm situata përmbajtje, deri tani Zoti na ka ruajtur dhe nuk kemi pasur fenomene të tilla atmosferike. Më kujtohet shumë mirë rezervuari i Manskurisë, si dhe situata kritike që kishte ky rezervuar, ne luteshim që të mos ndodhte diçka. Për fat, më vonë atje u bënë disa ndërhyrje dhe nuk pati fenomen cumani, sepse mund të kishte pasur fenomen cunami, i cili do të përmbyste digën dhe gjithë Golemin së bashku. Të gjitha investimet që ishin bërë, do të ishin shkatërruar.

Ky është një problem që nuk i takon këtij projektligji dhe ju na e sqaruat shumë mirë. Ju tashmë keni një objekt të specifikuar, bëhet fjalë për digat e baseneve, por meqë jemi duke folur për rrezik publik, duhen marrë me shumë seriozitet ato 600 apo 700 digat e tjera të rezervuarëve të bujqësisë, të cilat janë një rrezik permanent dhe mund të shkaktojnë katastrofa.

Gjithashtu, jam mëse i sigurt se që nga koha e Enverit atje nuk është vënë dorë, qoftë nga pikëpamja e largimit të rudimenteve, sepse aty rudimentet janë mbishtresuar duke u ngritur edhe tabani, kështu që ekziston edhe rreziku i daljes së ujërave përtej basenit ku ato duhet të mbliidhen dhe më pas çështja e digave, e portave që janë ndryshuar, janë dëmtuar e të tjera, të cilat mund të na krijojnë probleme jashtëzakonisht të mëdha.

E di që kjo kërkon një sforco shumë të madhe, por kjo gjë duhet menduar seriozisht. Nëse nuk ekzistojnë mundësi nga buxheti qeveritar, të trokasim në portat e donatorëve, të marrim kredi, sepse këto janë gjëra, të cilat rrezikojnë jo vetëm çështjen e përdorimit primar, sepse një pjesë e tyre janë edhe jashtë funksionit, e tha edhe zotëria, për të mos thënë që një pjesë e tyre janë futur për qëllime dytësore, janë devijuar nga qëllimi primar për njëmijë e një arsyë, ku një pjesë e tyre përdoret edhe për peshk.

Mendoj ta lëmë këtë histori, sepse kjo është një çështje që hap debat tjetër. Problemi qëndron te rreziku që ato paraqesin për popullatën që ndodhet poshtë dhe për këtë arsye mund të ketë efekte të padëshiruara, për të mos thënë fjalën e madhe, katastrofike. Ne duhet t'i dalim përpara këtij problemi që të mos ndodhemi para faktit të kryer, kur mund të jetë vonë dhe të përballemi me gjëra, të cilat edhe tani nuk mund t'i imagjinoj se çfarë mund të ndodhë në qoftë se do të cedojë një digë ku uji merr çdo gjë që i del para.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

A ka ndonjë përgjigje nga përfaqësuesit e ministrisë?

Agim Bregasi – Ajo që përmendi deputeti sa i takon financimit, në fakt, ky është vetëm një rialokim. Herë pas here ne kemi kaluar edhe financime, të cilat arrijnë deri 86 590 000 euro të dhëna nga donatorë të ndryshëm, siç e përmendi edhe zëvendësministria. Natyrisht, puna për mirëmbajtjen e digave, të portave dhe të agregateve të tjerë nuk mbaron me kaq, por nga studimi që është bërë në atë kohë janë parashikuar edhe punimet që duhej të ishin bërë nga KESH-i, i cili ka bërë shumë ndërhyrje të tjera me financimet e veta.

Sa i takon saktësisë në investime, gjithmonë në preventiv shkruhet edhe një 5% i paparashikuar. Pra, gjithmonë ka një kontingjent parash rezervë që mund të përdoren për raste të tilla dhe them se ky është rasti më i lehtë, sepse kaloi nga një pjesë e paalokuar në një investim real. Pra, ato para do të përdoren duke ndërhyrë nëpër turbina, për blerje pajisjesh dhe gjëra të tjera, një investim real për turbinat.

Shqetësimi për digat e bujqësisë është diçka tjetër.

Niko Peleshi – Po në lidhje me propozimin teknik për shtimin e fjalës (i ndryshuar), a keni ndonjë gjë për të na thënë?

Agim Bregasi – Në teknikën legislative, sepse unë nuk jam ligjvënës, thuhet se titulli i referohet gjithmonë ligjit bazë. Pra thuhet: “Për një ndryshim në ligjin aq e...”

Ilir Beqaj – Atë nuk po e prekim, por kërkojmë vetëm të thuhet (i ndryshuar), sepse mund të ketë ndryshim të zërave...

(Diskutime pa mikrofon)

Ku është në titull ndryshime? Nuk është.

(Diskutime pa mikrofon)

Për një ndryshim, pra, kur të dalë ligji, do të thotë i ndryshuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi -- A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Vazhdojmë me diskutime.

Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani - Në varësi edhe të axhendës që do të kemi, edhe në varësi të shqetësimit të ngritur nga disa kolegë, por edhe nga zoti Panariti, të organizojmë një seancë dëgjimore për gjendjen e sigurisë së digave, me të gjithë aktorët që janë të angazhuar dhe kontribuojnë në këtë fushë, me qëllim që të evidentojmë dhe diskutojmë për situatn reale të digave dhe çfarë mund të bëhet për ta përmirësuar atë.

Sa i përket kësaj marrëveshjeje së pari, kalimi i buxheti nga njëri zë tek tjetri, pra kalimi nga asistenca teknike tek investimet, duhet vlerësuar. Ne e diskutuam këtë edhe në Komisionin e Jashtëm.

Ajo që vlen të përmendet këtu është fakti që e gjithë kjo ka një afat kohor për t’u realizuar duke shtyrë afatin për të realizuar projektet infrastrukturore.

Sa i përket këtij investimi ose ndryshimi infrastrukturor unë mendoj që është pak e vështirë në projekte kaq të mëdha infrastrukturore, aq më tepër kur marrëveshja është lidhur disa vite më parë, të parashikohen të gjitha këto ndërhyrje dhe është disi e kuptueshme që mund të dalin gjëra që nuk janë parashikuar në fillim. Jo gjithmonë ka shkuar me konotacion negativ, që lë shteg për abuzime, por, nëse vërtet dalin gjëra të paparashikuara, të mund të mbulohen brenda shumës së buxhetit duke mos pasur nevojë për marrje të tjera fondesh.

Unë jam për të votuar pro këtij projektligji.

Niko Peleshi –A ka diskutime të tjera?

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Së pari, kam një kërkesë të vogël për përfaqësuesit e ministrisë që, nëse munden, të bëjnë një sforco, deri ditën e mërkurë të na sjellin të matshëm në megavat/orë leverdinë e eficiencës me këto ndërhyrje që janë bërë.

Së dyti, kjo është një marrëveshje e vitit 2012 dhe në tekstin bazë në këtë marrëveshje kemi marrë kredi edhe për digat e Ulzës, pasi morëm kredinë në vitin 2012. Në pranverë të vitit 2013 e shitëm Ulzën dhe Bistricën, por ai burri i botës fiton lekë, ndërsa ne vazhdojmë ta paguajmë sot kredinë. Ky duhet të jetë një lloj reflektimi për gabimet ose krimet e bëra në vite në kurriz të sistemit energjetik.

Ajo që unë kam si shqetësim dhe mbase shkon përtej kësaj, ju thatë që keni një rregullore të vitit 1998, që sot mbulon vetëm 3 digat e Drinit, por situata e digave vetëm për energjetikë është më komplekse sot në Shqipëri. Unë mendoj se ju keni për detyrë parësore ta rishikoni këtë rregullore. Pse? Sepse në pranverë futen edhe dy digat e Devollit në funksionim që do të thotë, përveç sigurisë ajo kaskadë ka nevojë për rikonceptim dhe rimenaxhim të burimeve hidrike, sepse, nëse OSHEE-ja sot ka për detyrë t'ua blejë me detyrim atyre të vegjëlve, një pjesë e mirë e ujit që rri atje nuk mund të menaxhohet më me parimet e vitit 1988, sepse bashkë me futjen e plotë të Devollit në pranverë rezervat e kaskadës nuk kalojnë më shumë se 75% të rezervave që kemi në basene me diga për të prodhuar energjinë. Viti 2018, që ka qenë mbase viti më i mirë në reshje në 10 vjetët e fundit, dhe më i mirë në prodhimin që ka dhënë kaskada në metra katrorë, financiarisht nuk ka rezultuar kështu, mund të ketë rezultuar për buxhetin e vetë KESH-it, por në OSHEE-, situata është njëlloj. Kështu që në funksion të këtij konteksti që ka sistemi energjetik shqiptar, qoftë modeli i tregut, qoftë fakti që tani kemi dy digat e mëdha të Devollit, plus unë nuk e kam të qartë si funksionon Ashta, sepse ajo ka një model tjetër si e

përdor ujin, unë mendoj që ju duhet ta rivlerësoni rregulloren e vitit 1988. Kur kemi miratuar rezolutën e ERE-s ua lamë edhe atyre për detyrë, unë nuk e di çfarë ndikimi ka ERE-ja, që t'ju imponohet juve për të rishikuar rregulloren në funksion të shfrytëzimit optimal të ujit që kemi në kaskadë.

Faleminderit!

Niko Peleshi - A ka diskutime të tjera?

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Këtu besoj ka nevojë për një korrektim, sepse shikoj që nuk janë shkruar në draft nenet. Pra, duhet saktësuar neni 1 dhe neni 2.

Neni 1 “Për ratifikimin në letër të marrëveshjes ndryshuese së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e shtesës së financimit të digave, të ratifikuar me ligjin nr. 40, të vitit 2012, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi”.

Neni 2 “Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare”.

Nëse jeni dakord me këtë korrektim, e hedhim në votimin nenin 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me miratimin në tërësi të projektligjit. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit. Sapo ju është shpërndarë projektkalendari për punimet e komisionit në vazhdim.

Ditën e martë është parashikuar prezantimi i projektligjit për eficiencën, me relator deputetin Arben Pëllumbi; ditën e mërkurë prezantimi i projektligjit për peshkimin me relatore zonjën Gjermani; ditën e hënë në datën 4 shkurt seancë dëgjimore për kandidaturat për kryetar

dhe anëtar të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë dhe të martën në datën 5 shkurt votimi i projektligjit për peshkimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mërkurën prezantimi dhe në datën 5 votimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A jeni dakord me kalendarin?

Miratohet.

Orari do të njoftohet nga Elona.

Miratohet.

MBYLLET MBLEDHJA